

POLITIKAT NË FOKUS: Mundësitë dhe procedurat për eksport në SHBA



Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

'Politikat në Fokus' është publikim i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë që ka për synim të sjellë vëmendjen në politika të ndryshme ekonomike që ndikojnë në zhvillimin e sektorit privat në vend. Ky edicion trajton marrëdhëniet tregtare mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe procedurat e aplikueshme për eksportin e produkteve kosovare në tregun e SHBA. Dokumenti përmban shembuj specifik për rregullat dhe kriteret në fuqi për artikuj të ndryshëm, si dhe u mundëson lexuesve të interesuar të mbledhin më shumë informata mbi tema të caktuara përmes klikimit në faqe të lidhura me dokumentin.

Hyrje

'Deficit dërmues tregtar' është një frazë që është përdorur shpeshherë për të portretizuar situatën aktuale të Kosovës sa i përket tregtisë ndërkombëtare në mallra. Sektori i prodhimit në vend ka hasur sfida të konsiderueshme për t'u ballafaquar me konkurrencën nga vendet e rajonit dhe më gjerë. Përderisa ka shenja inkurajuese për rritjen e konkurrueshmërisë së kompanive kosovare viteve të fundit, është e qartë se nevojitet një përpjekje shumë e madhe për të ndryshuar trendin e tanishëm të tregtisë. Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, deficitin tregtar mesatarisht ka arritur vlerat rreth 2 miliardë euro në baza vjetore. Për të vendosur këtë shumë në perspektivë, të hyrat e parapara buxhetore të Kosovës për vitin 2017 janë 1.7 miliardë euro.

Kjo dalje e parasë së gatshme nga tregu kosovar pjesërisht rikuperohet përmes eksportit të shërbimeve, investimeve të huaja

direkte, dhe në masë të madhe falë remitencave të diasporës së Kosovës nga vende të ndryshme të botës. Bilanci i pagesave në Kosovë do të ishte tejet më shqetësues nëse këto remitencat do të largoheshin nga ekuacioni.

Megjithatë, duhet të theksohet se ekzistojnë mundësi të shumta që prodhuesit kosovarë duhet të eksplorojnë për t'iu qasur tregjeve të huaja dhe për të ndihmuar në uljen e këtij deficiti. Në aspekt të marrëdhënieve tregtare me Bashkimin Evropian, Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, që i ofron produkteve kosovare qasje pa detyrime doganore në tregjet e shteteve anëtare të BE, përderisa liberalizimi për produktet e BE do të bëhet gradualisht. Në anën tjetër, Kosova listohet në mesin e shteteve përfituese të Sistemit të Përgjithshëm të Preferencave (GSP), një program i preferencave tregtare i SHBA që ka për qëllim të ndihmojë shtetet në zhvillim.

Përkundër që Kosova është shtet përfitues i GSP, shumë lehtë mund të shihet se prodhuesit nuk kanë arritur të shfrytëzojnë më së miri këtë mundësi. Për periudhën 2012-2016, vlera totale e eksporteve të Kosovës drejtuar SHBA (përfshirë ri-eksportin) ka arritur vetëm 7.4 milionë euro, përderisa vlera korresponduese për eksportet e SHBA në Kosovë është 250.5 milionë euro. Kjo do të thotë se shkalla e mbulueshmërisë së importit me eksport për këtë periudhë në raport me SHBA është 2.9%. Si krahasim, shkalla e mbulueshmërisë në tregti ndërkombëtar të Kosovës me të gjitha vendet sillet rreth 11.5-12.5%, gjë që sugjeron se edhe brenda kornizës aktuale, mundësitë e tregtisë me SHBA nuk janë shfrytëzuar sa duhet.

Procedurat e importit në SHBA dhe rolet e institucioneve të ndryshme

Ka një numër të institucioneve dhe agjencive që kanë role të ndryshme në procedura të importit në Shtetet e Bashkuara para se produktet të mund të plasohen në treg. Kjo pjesë e dokumentit sqaron rolin e 3 institucioneve, gjegjësisht Agjencisë për Dogana dhe Mbrojtje Kufitare (Customs and Border Protection Agency), Agjencisë për Ushqim dhe Medikamente (Food and Drug Administration), dhe Byrosë për Tatim dhe Tregti të Alkoolit dhe Duhanit (Alcohol and Tobacco Tax, and Trade Bureau)

Agjencia për Doganë dhe Mbrojtje Kufitare

Në aspekt të procedurave të përgjithshme doganore, institucioni kryesor me të cilën komunikojnë importuesit dhe eksportuesit është Agjencia për Doganë dhe Mbrojtje Kufitare (CBP). Misioni i këtij institucioni si agjenci për zbatim të ligjit shtrihet përtej tregtisë dhe përfshin edhe sigurimin e kufijve të Shteteve të Bashkuara. CBP vepron përmes Zyrave Operative të Terrenit, që monitorojnë të gjitha pikat kufitare (hyrëse) për produkte. Portet e hyrjes janë niveli në të cilën CBP zbaton legjislacionin për import dhe eksport, duke përfshirë pagesën e detyrimeve doganore dhe procedurat për zhdoganim. Importuesit duhet të ushtrojnë kujdes të arsyeshëm për të vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe nëse një gjë e tillë kërkohet, të kontaktojnë agjencitë tjera zbatuese kur ka paqartësi mbi importin e artikujve të caktuar që hyjnë në fushëveprimin e agjencive tjera (siç është Agjencia për Ushqim dhe Medikamente)

Që një dërgesë të hyjë në tregun e SHBA, importuesit duhet të kalojnë në një proces që përfshinë dy hapa, gjegjësisht (1) paraqitjen e dokumenteve që vërtetojnë që mallrat mund të lëshohen nga kontrolli i CBP, dhe (2) dorëzimin e dokumenteve që përmbajnë

informata për të caktuar detyrimet doganore dhe për qëllime statistikore.¹ Lista e mëposhtme jep një pasqyrë të dokumenteve që nevojiten në procedura të importit për futjen e produkteve:

- Manifesti i produkteve që do të hyjnë në treg ([Formulari CBP 7533](#))
- Dëshmi për të drejtën e hyrjes
- Faturë komerciale
- Listën e paketimit
- Dokumente tjera që vërtetojnë pranueshmërinë e produkteve.

Pas paraqitjes së hyrjes, CBP ka autoritetin që të inspektojë apo jo një dërgesë specifike. Rrjedhimisht, "dokumenti përmbledhës i zhdoganimit dorëzohet dhe detyrimet doganore llogariten brenda 10 ditësh që nga hyrja e produkteve në një pikë doganore të caktuar"² Gjithashtu importuesit duhet të ofrojnë një garancion për të mbuluar detyrimet e mundshme doganore apo ndonjë tatim tjetër. Në këtë pikë, importuesit duhet të dorëzojnë një Formë Përmbledhëse të Zhdoganimit ([Formulari CBP 7501](#)). Shumë nga këto procese mund të kryhen në mënyrë elektronike përmes Programit të Automatizuar të Ndërmjetësimit/Shpedicionit (Automated Broker Interface- ABI)

Mallrat që arrijnë në SHBA mund të futen nga pronari, blerësi, një punonjës i autorizuar, apo përmes një ndërmjetësi doganor të licencuar. Ndërmjetësit e licencuar doganor janë agjentët e vetëm të autorizuar sipas ligjit në fuqi për t'u marrë me transaksione doganore.

CBP u rekomandon eksportuesve dhe importuesve që të sigurohen që produktet janë paketuar si duhet dhe faturat dhe dokumentet përcjellëse janë përgatitur me kujdes, në mënyrë që të përshpejtohen procedurat doganore.

¹ Agjencia për Doganë dhe Mbrojtje Kufitare, "Importi në Shtetet e Bashkuara: Udhërfyës për importues komercial"

² Id.

Legjislacioni në fuqi në SHBA gjithashtu kërkon që të gjitha produktet e importuara të përmbajnë emrin në gjuhën angleze të vendit të origjinës (për të gjitha produktet). Megjithatë, përpos shënimit të vendit të origjinës, importuesit duhet të sigurohen që të veprojnë në përputhje edhe me kërkesat tjera të agjencive të ndryshme për etiketim dhe shënim të produkteve.

Agjencia për Ushqim dhe Medikamente (FDA)

Përpos procedurave të përgjithshme të zhdoganimit që administrohen dhe mbikëqyren nga CBP, ekzistojnë një numër i agjencive federale që kanë përgjegjësi të konsiderueshme në importin e artikujve të ndryshëm. Agjencia për Ushqim dhe Medikamente (FDA) rregullon importin e një numri të madh të produkteve ushqimore (me përjashtim të artikujve që rregullohen dhe mbikëqyren nga Departamenti për Agrikulturë i Shteteve të Bashkuara) dhe medikamenteve.

Kur një ndërmjetësues doganor paraqet produktet e një dërgese për zhdoganim sipas kodeve tarifore përkatëse të Skemës së Harmonizuar të Tarifave (HTS), kodi tarifor do të njoftoj automatikisht kur një produkt hyn në fushëveprimin e FDA. Në raste të tilla, ndërmjetësi doganor do të duhet të ofrojë informatat e mëposhtme për FDA:

- FDA Vendi i origjinës
- FDA Kodi i produktit*
- FDA Prodhuesi
- FDA Transportuesi
- FDA Vërtetimi i përputhshmërisë (siç janë certifikatat e lëshuara nga autoritetet inspektuese)
- Shuma dhe vlera³

Duhet të theksohet se kodet e produkteve sipas FDA janë krejtësisht ndryshe nga kodet tarifore që përdoren në procedura

doganore. Kodet e produkteve mund të krijohen në mënyrë elektronike duke [klikuar këtu](#) dhe duke i përcjellë instruksionet e mëpasshme. Produktet e ndryshme kanë kode të ndryshme të identifikimit, varësisht përmbajtjes dhe mënyrës së paketimit të produkteve. Për shembull, një lëng jo i gazuar me bazë citrusi në paketim xhami do të ketë FDA kodin e produktit "29 A C E 02".

Duhet të theksohet se importuesit mund të importojnë produkte ushqimore në SHBA **pa autorizimin paraprak të FDA**, përderisa objektet që prodhojnë, ruajnë apo transportojnë produktet janë të regjistruara në FDA, dhe agjencisë i jepet njoftim paraprak për importin e produkteve (sqsuar më poshtë).

Legjislacioni i SHBA kërkon që të gjitha produktet që shiten në tregun e Shteteve të Bashkuara të përmbajnë etiketime në gjuhën angleze, që përmbajnë informatat në vijim:

- Identitetin e produktit
- Emri, adresa apo numri i telefonit i kompanisë përgjegjëse (prodhuesi apo distributori)
- Listën e përbërësve të produktit radhitur sipas përbërësve më të mëdhenj
- Peshën neto të përbërësve në sistemin metrik dhe në atë anglez.
- Informacion mbi vlera ushqyese
- Deklaratë në etiketë që tregon vendin e origjinës së produktit.

Për më shumë, vlen të theksohet se një numër i produkteve kërkohet që të jenë të prodhuara në objekte që zbatojnë plan të sigurisë sipas HACCP (Hazard Analysis and Critical Control Point).

Regjistrimi e Objekteve Ushqimore (FDA) dhe Njoftimi Paraprak

Ligji për Sigurimin e Shëndetit Publik dhe Gatishmërisë për Reagim ndaj Bioterorizmit i

³ Për të shikuar procesin e plotë të hyrjes së produkteve (sipas FDA), ju lutem [klikoni këtu](#).

vitit 2002 kërkon nga të gjithë prodhuesit e produkteve që synohet të shiten në SHBA të regjistrojnë objektet e tyre në FDA. Procedura e regjistrimit mund të kryhet në mënyrë elektronike dhe është pa pagesë; megjithatë, të gjitha entitetet e huaja duhet të ofrojnë një Agjent tregtar që vepron në Shtetet e Bashkuara. Një sqarim i procedurave për regjistrimin e Objekteve Ushqimore mund të gjendet duke [klikuar këtu](#).

Ligji i sipërpërmendur gjithashtu kërkon që të dërgohet njoftim paraprak tek FDA për të gjitha produktet ushqimore që do të importohen në SHBA. Qëllimi i programit të njoftimit paraprak është që të shqyrtohet dhe vlerësohet informacioni për importin e produkteve ushqimore dhe për të ndërtuar një sistem më efektiv të inspektimit. Njoftimi paraprak për FDA duhet të dërgohet jo më shumë se 30 ditë para se dërgesa të arrijë në portin e hyrjes nëse dërgohet përmes ABI (Automated Broker Interface), apo jo më shumë se 15 ditë nëse dërgohet përmes Sistemit Elektronik për Njoftim Paraprak të FDA. Gjithashtu, këto njoftime paraprake duhet të dërgohen jo më pak se 4 apo 8 orë para aritjes në portin e hyrjes, varësisht se a vjen dërgesa përmes rrugëve ajrore (4) apo ujore (8).⁴

Eksportimi i Pijeve Alkoolike - Byroja për Tatime dhe Tregti të Alkoolit dhe Duhanit

Kërkesat e përgjithshme nën fushëveprimin e FDA të sqaruara në pjesën e mësipërme janë gjithashtu të aplikueshme për importin e pijeve alkoolike në Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, në përputhje me Ligjin Federal të Administrimit të Alkoolit, një numër i kërkesave shtesë duhet të përmbushen.

Së pari dhe më kryesorja, njësia eksportuese duhet të aplikojë për një leje bazike të importit në Byronë për Tatime dhe Tregti të Alkoolit dhe Duhanit. Procesi për aplikimin

për leje të importit mund të bëhet [në mënyrë elektronike](#), apo duke plotësuar dhe dorëzuar [Formularin TTB 5100.24](#). Për të marrë një leje, aplikantët duhet të krijojnë dhe mbajnë një zyrë biznesi në SHBA. Megjithatë, si një alternativë, një njësi eksportuese mund të kontrakttojë një importues ekzistues të licencuar në Shtetet e Bashkuara dhe kjo eliminon kërkesën për marrjen e lejes së importit krejtësisht.

Përveç lejes bazike të importit, një proces shumë i rëndësishëm përpara se një pije alkoolike të fillojë të shitet komercialisht në SHBA është marrja e Certifikatës për Aprovim të Etiketës (COLA) nga kjo Byro. COLA duhet të merret për çdo produkt specifik që synohet të importohet në Shtetet e Bashkuara. COLA synon të sigurojë që pijet alkoolike të jenë të etiketuara në përputhje me ligjin në fuqi sa i përket paralajmërimeve shëndetësore, sulfiteve, përmbajtjes alkoolike etj. Procesi për aplikimin për COLA mund të përfundojë [në mënyrë elektronike](#) përmes faqes zyrtare të internetit, ose duke paraqitur një formular të plotësuar [Formularin TTB 5100.31](#).

Ekzistojnë kritere shtesë të parashikuara nga ligji për importimin e pijeve alkoolike të veçanta në SHBA, si kërkesa për "çertifikatën e verës natyrale" ose "çertifikatën e kërkesave për moshën dhe origjinën".

Eksportimi i Produkteve Bujqësore

Pemët dhe perimet e freskëta

Bujqësia shpeshherë përmendet si sektor me potencial të theksuar për Kosovën, duke pasur në konsideratë disponueshmërinë e tokës bujqësore, përbërjen demografike të popullatës dhe koston e lirë të fuqisë punëtore në këtë sektor. Faktikisht, kontributi i bujqësisë në Bruto Produktin Vendor në Kosovë ka lëvizur nga 10 deri në 15 për qind në periudhën mes viteve 2008 dhe 2015,

⁴ Për informata më të hollësishme mbi Programin për Njoftim Paraprak të FDA, ju lutem [klikoni këtu](#).

kontribut ky që rivalizohet vetëm nga sektori i shitjes me shumicë dhe pakicë. Megjithatë, cilat janë realisht potencialet e Kosovës për eksport të pemëve dhe perimeve në tregun e SHBA? A ka kërkesa specifike apo kufizime që duhet të kalohen?

Importi i frutave dhe perimeve të freskëta në territorin e SHBA monitorohet nga Departamenti për Bujqësi, një institucion i përbërë nga 29 agjenci dhe zyre nëpër SHBA. USDA mirëmban një bazë të dhënave për produkte të freskëta të cilave u lejohet hyrja në SHBA, bazuar në vendin e origjinës. USDA ka publikuar një udhëzues që ofron një listë të produkteve për të cilat nuk ka nevojë për leje në import nga të gjitha shtetet e botës, si dhe lista të veçanta sipas shteteve.⁵ Lista e mëposhtme është gjithëpërfshirëse dhe jo domosdoshmërisht të gjitha produktet mund të prodhohen në Kosovë.

Aprovuar për gjitha shtetet:

- Aloe vera (pjesët mbi tokë)
- Arrë "lakuriqi" (aziatike)
- Frut "Cannonball" (amerikë jugore)
- Gështenjë e ujit kineze
- Arrë kokosi
- Cyperus
- Lule të ngrëshme (vetëm inforoscente)Thelpinj hudhre, e qëruar
- Thelbinj hudhre
- Rrënjë xhenxhefil
- Lily bulb (Lilium spp.)
- Fletë Maguey
- Matsutake (këpurdhë aziatike)
- Këpurdha
- Zemra (brendësia) e palmës, e qëruar
- Kikirikë
- Shega
- Ceratonia siliqua
- Arrë "Singhara" (Trapa bispinosa)
- Tamarind (arrë afrikane)
- Zhardhok këpurdhash
- Gështenjë e ujit (Trapa natans)

⁵ Udhërrëfytyesi i USDA për Importin e Pemëve dhe Perimeve të Freskëta mund të gjendet duke [klikuar këtu](#), përderisa baza e kërkueshme e të dhënave

Siç reflektohet në tabelë, lista e tanishme e pemëve dhe perimeve të lejuara për Kosovën është shumë kufizuese dhe përjashton një numër të madh të produkteve që potencialisht Kosova mund t'i prodhojë dhe eksportoje në tregun e SHBA. Rrjedhimisht, institucioneve kosovare u kërkohet të ndjekin një numër të procedurave në mënyrë që të zgjerojnë listën e produkteve të kësaj natyre, varësisht potencialit eksportues:

1. Fillimisht, Organizata Kombëtare për Mbrojtjen e Bimëve (NPPO) në Kosovë duhet të fillojë një Analizë për Rrezik nga Insektet (dëmtuesit) me Departamentin për Bujqësi të Shteteve të Bashkuara-Shërbimin Inspektues për Shëndet të Kafshëve dhe Bimëve (APHIS) për secilin produkt. Në rastin e Kosovës, rolin e NPPO e kryen Agjencia e Ushqimit dhe

Aprovuar për Kosovën në veçanti:

- Hudhër (vetëm ngarkesa komerciale)
- Rrikë
- Dredhëza
- Patate e ëmbël, T101-f-3
- Cipollini (qepë e egër)
- Dasheen
- Ethrog, T107-a

për produktet e lejuara së bashku me Kërkesat për Import të Artikujve mund të gjendet duke [klikuar këtu](#).

Veterinës. Kërkesa për një analizë të rrezikut duhet të shoqërohet me një numër të dokumenteve që listohen në Rregullën Federale 7 CFR 319.5(d)⁶

2. Rrjedhimisht, APHIS do të kryejë analizën e rrezikut nga insektet (dëmtuesit) në shtetin aplikues, në përputhje me standardet ndërkombëtare për masa fito-sanitare, të aprovuara nga Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve.⁷
3. Pasi kjo analizë të japë rezultate të kënaqshme dhe APHIS vlerëson se produkti apo produktet mund të importohen në territorin amerikan, të njëjtit do ta nxjerrin aprovimin potencial në diskutim publik. Vetëm pas kësaj procedure, leja për import të produkteve mund të lëshohet.

Megjithatë, vlen të theksohet se kjo procedurë e sqaruar më sipër mund të zgjasë me vite të tëra, dhe jo domosdoshmërisht rezulton në aprovim të kërkesës. Prandaj, nëse ka plane për eksportimin e pemëve dhe perimeve specifike në territorin e SHBA, procedura për marrjen e lejes duhet të iniciohet shumë më herët, në mënyrë që të rriten gjasat për sukses.

Mishi, pulat dhe vezët

Departamenti i SHBA për Bujqësi, Shërbimi për Siguri dhe Inspektim të Ushqimit (FSIS), është përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e importit të gjitha llojeve të mishrave, duke përfshirë mishin e viçit dhe të pulës, si dhe importit të vezëve në territorin e SHBA. Procedura për importin e këtyre produkteve në fakt është e ngjashme me importin e pemëve dhe perimeve, ku shtetet duhet të aplikojnë që të bëhen eksportues të mundshëm. Momentalisht, Kosova nuk është e përfshirë në listën e shteteve eksportuese

dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë hap në këtë drejtim.

Shtetet që dëshirojnë të bëhen eksportues të mishit dhe vezëve duhet të dërgojnë një aplikim formal tek USDA FSIS. Vlerësimi i shteteve aplikuese bëhet bazuar në (1) shqyrtim të dokumentacionit dhe (2) vizitës në terren. Shqyrtimi i aplikacionit përfshin një vlerësim gjithëpërfshirës të ligjeve, rregulloreve dhe praktikave të shtetit aplikues në pesë fusha të riskut, gjegjësisht fushën e kontaminimit, sëmundjeve, prodhimit, mbetjeve, si dhe pajtueshmërisë ligjore dhe mashtrimit ekonomik. Rrjedhimisht, një ekip teknik do të vizitojë shtetin aplikues me qëllim të kryerjes së një vlerësimi në terren dhe për të vlerësuar objektet e prodhimit dhe makinerinë, laboratorët, programet e trajnimit, dhe sistemet inspektuese brenda fabrikave.

“Nëse FSIS vlerëson sistemin inspektues ekuivalent me atë të SHBA, FSIS nxjerr rregulla të cilat kur kompletohen rezultojnë në listimin e shtetit në rregulloret Federale 9CFR 327.2 për mish dhe 9CFR 381.196 për pulë, me të drejtë importimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Pasi që të përfundohen aktivitetet e mësipërme, sistemi inspektues i shtetit të huaj është përgjegjës për certifikimin e entiteteve eksportuese.⁸ Nga shtetet rajonale, vetëm Kroacia listohet si shtet i mundshëm eksportues, dhe tre entitete janë regjistruar deri tani për eksportimin e produkteve të mishit nga ky shtet.

⁶ Lista e dokumenteve për Analizë të Rrezikut për Insekte mund të gjendet duke [klikuar këtu](#).

⁷ Standardet Ndërkombëtare për Masat Fitosanitare mund të gjenden duke [klikuar këtu](#).

⁸ Lista e plotë e shteteve që mund të eksportojnë produkte të mishit në SHBA mund të gjendet duke [klikuar këtu](#).

Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave

Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave (GSP) është program tregtar i preferencave i themeluar nga Shtetet e Bashkuara me qëllim të ofrimit të mundësive të eksportit për një numër të shteteve më pak të zhvilluara dhe shteteve në zhvillim. Ky program që është themeluar përmes Ligjit për Tregti të vitit 1974, përmban aranzhime preferenciale sa i përket detyrimeve doganore për shtetet përfituese, duke përfshirë Republikën e Kosovës. GSP klasifikon 3,500 produkte sipas kodeve tarifore (Skemës së Harmonizuar të Tarifave të Shteteve të Bashkuara – HTSUS), që u jepet qasje pa tarifa doganore për të gjitha Shtetet Përfituese në Zhvillim (BDC) dhe 1,500 produkte tjera të cilat përfitojnë qasje në tregun e SHBA pa detyrime doganore vetëm për Shtetet Përfituese më Pak të Zhvilluara (LDBDC).

Kosova, ngjashëm me shtetet rajonale si Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe

Bosnja & Hercegovina, i përket listës së shteteve në zhvillim (BDC), dhe rrjedhimisht ka 3,500 produkte të cilat kanë trajtim preferencial sipas GSP. Lista e shteteve përfituese nga GSP jepet në Tarifën e Harmonizuar (HTSUS), nën kaptinën “Shënimet e Përgjithshme”.⁹

Eksportuesit potencial në territorin e Shteteve të Bashkuara, para se të fillojnë procedurat eksportuese, fillimisht duhet të shikojnë se a hyn produkti i tyre në listën e GSP. Janë dy mënyra për ta bërë një gjë të tillë: duke shikuar listën e produkteve nën GSP për Shtetet në Zhvillim (BDC) në [ueb faqen e Zyrës së Përfaqësuesit të Tregtisë së Shteteve të Bashkuara](#) (Office of the United States Trade Representative), ose duke shikuar kapitullin përkatës të [Tarifës së Harmonizuar të Shteteve të Bashkuara](#) (HTS). Më e preferueshme është që të shikohet kjo e fundit, meqenëse të gjitha amendamentet së pari reflektohen në HTS. Produktet

Si të shikohet se a është një produkt i përfshirë në GSP?

Shembull: Një prodhues i verës që dëshiron të eksportojë në Shtetet e Bashkuara

Hapi i parë: Të gjendet kodi 8-shifror i HTS për atë produkt (shembull: 22041000)

Hapi i dytë (i rekomanduar): Të shkarkohet kapitulli përkatës i [Skemës së Tarifave të Harmonizuara](#). Në këtë rast, eksportuesit duhet të shkarkojnë Kapitullin 22- “Pijet, alkoolet dhe uthullat”. Në dokumentin e shkarkuar, eksportuesit duhet të gjejnë nënkryen përkatës, që në këtë rast është në faqen 6 të dokumentit. Pasi të gjendet produkti i kërkuar, përdoruesit vërejnë se pjesa “Norma të detyrimit” (Rates of Duty), përmban tre kolona: Të përgjithshme dhe speciale nën kolonën “1”, si dhe një kolonë tjetër “2”. Kolona nën “speciale” tregon se a është një produkt i përfshirë në GSP. Nëse emërtimi “A” është i pranishëm në këtë kolonë, siç është rasti i verës së gazuar, kjo do të thotë që produkti mund të eksportohet nga Kosova për SHBA pa detyrime doganore. Gjithashtu, lista tregon se në tregti nga vendet tjera, produkti i nënshtrohet detyrimit doganor prej 19.8 cent për litër (apo 1.59 dollarë për litër në importet nga Koreja e Veriut apo Kuba).

Hapi i dytë (Alternativ): Të vizitohet ueb faqja e [Zyrës së Përfaqësuesit të Tregtisë](#) (USTR). Në këtë rast, produkti me kodin 22041000 – “Verë e gazuar, e prodhuar nga rrushi”, është e përfshirë në listë dhe kolona përkatëse e GSP përmban shënimin “A”, që do të thotë se produkti ka trajtim preferencial për Kosovën.

Hapi i tretë 3: Pasi të verifikohet se produkti është i përfshirë në listën e GSP, eksportuesit duhet të ndjekin hapat e mëtuajtshëm në koordinim me importuesit për t’u siguruar se produktit i jepet trajtim preferencial në tregti.

⁹ Shënimi i Përgjithshëm 4(a) i Skemës së Harmonizuar të Tarifave jep listen e plotë të Shteteve në Zhvillim, përfituese të GSP.

përfituese sipas GSP shënohen me "A", përderisa produktet për shtetet më pak të zhvilluara (LDBDC) shënohen me "A+".

Si të kërkohet trajtim sipas GSP

Në mënyrë që të kërkohet që një produkt të trajtohet sipas rregullave të GSP (të jetë i liruar nga detyrimet doganore), importuesi në Shtetet e Bashkuara duhet të kërkojë aplikimin e preferencës tregtare duke përdorur Indikatorin e Programit Special të GSP si prefiks para numrit tarifor HTSUS, në kohën e përgatitjes së dokumenteve zhdoganuese. Në rastin e aplikueshmërisë së GSP për Kosovën, importuesi duhet të shënojë produktin me prefiksin "A" (shembull: A22041000). Nëse për një arsye apo tjetër importuesi nuk kërkon trajtim sipas rregullave të GSP gjatë importit, ekzistojnë mënyra që një gjë e tillë të kërkohet më vonë.¹⁰

Agjencia për Doganë dhe Mbrojtje Kufitare (CBP) mund të kërkojë dokumentacion për të verifikuar trajtimin e produkteve nën GSP, dhe kërkesa për dokumentacion mund të ndryshojë nga një rast në tjetrin. Megjithatë, udhërrëfyesi për GSP jep një listë të përgjithshme të dokumenteve që duhet përgatitur paraprakisht që të lehtësohet kjo procedurë:

- Deklarata e GSP (Dëshmi e vendit të origjinës) - [19 CFR 10.173](#)
- Listën e lëndës së parë- *Bill of Materials*
- Faturat
- Dëshmitë e blerjeve
- Shënimet e prodhimit që mbahet rregullisht në kompani
- Informacione mbi pagesën e punëtorëve për të dokumentuar koston e fuqisë punëtore
- Profil i prodhuesit
- Afidaviti (dëshmi nën betim) me dokumentacion mbështetës

Sa i përket kriterit për Vendin e Origjinës "në mënyrë që një produkt të trajtohet si i pranueshëm për qëllime të GSP, duhet të jetë i rritur apo i prodhuar në një shtet në zhvillim (BDC), dhe shuma e përgjithshme e kostos apo vlerës së materialeve të prodhuara në BDC si dhe kostos direkte të përpunimit duhet të jetë së paku **35% e vlerës së produktit** në fjalë, në kohën kur produkti hyn në Shtetet e Bashkuara"¹¹

CBP ka për detyrë të vlerësojë se a janë përmbushur kriteret e fitimit të vendit të origjinës. Prodhuesit mund të përdorin lëndë të parë të importuar për të arritur 35 për qindëshin, përderisa produktet e importuara kalojnë transformim substancial gjatë përpunimit. Gjithashtu, produktet për të cilat do të kërkohet trajtim sipas GSP duhet të transportohen direkt në SHBA dhe mund të kalojnë nëpër territore të shteteve tjera vetëm si transit (pa hyrë në tregun e asnjë shteti tjetër).

Shtetet që për momentin përfitojnë nga GSP mund të "diplomohen" nga ky program dhe rrjedhimisht të përjashtohen nga lista bazuar në faktorë të ndryshëm si të hyrat kombëtare dhe konkurrueshmëria. Diplomimi ndodh kur (a) Presidenti jep një vlerësim se shteti ka kaluar kufirin e një vendi me të ardhura të larta sipas standardeve të Bankës Botërore, ose (b) si rezultat i avancimeve të shtetit përfitues në zhvillim ekonomik dhe konkurrueshmërinë tregtare.

¹⁰ Procedurat për të aplikuar për përfitim nga GSP pas procedurës së importit janë të sqaruara në [Udhërrëfuesin për GSP](#).

¹¹ Udhërrëfyesi për Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave të SHBA, f.13

Lista e Akronimeve

APHIS - Shërbimi Inspektues për Shëndet të Kafshëve dhe Bimëve

ATTB - Byroja për Tatim dhe Tregti të Alkoolit dhe Duhanit

BDC – Shtetet përfituese në Zhvillim

CBP – Agjencia për Doganë dhe Mbrojtje Kufitare

COLA – Certifikatë për Aprovim të Etiketës për produkte alkoolike

FDA – Administrata për Ushqim dhe Medikamente

FSIS – Shërbimi për Siguri dhe Inspektim të Ushqimit

GSP – Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave

HTSUS – Skema e Harmonizuar e Tarifave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

LDBDC – Shtetet përfituese më pak të zhvilluara

USDA – Departamenti për Bujqësi i Shteteve të Bashkuara

Referencat

Agjencia për Ushqim dhe Medikamente. (2009, Prill). Çfarë ju duhet të dini për "Njoftimin Paraprak" për importin e produkteve ushqimore. Gjetur në <https://www.fda.gov/downloads/food/guidanceregulation/ucm140285.pdf>

Departamenti për Bujqësi i Shteteve të Bashkuara. (2012). Udhërrëfyesi për Pemë dhe Perime të Freskëta. Gjetur në https://www.aphis.usda.gov/import_export/plants/manuals/ports/downloads/fv.pdf

Departamenti për Siguri Kombëtare- Agjencia për Doganë dhe Mbrojtje Kufitare. (2006). Importi në Shtetet e

Bashkuara: Udhërrëfyesi për importues komercial. Gjetur në <https://www.cbp.gov/sites/default/files/documents/Importing%20into%20the%20U.S.pdf>

Sekretariati i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Bimëve. (2016). Standardet Ndërkombëtare për Masat Fitosanitare. Gjetur në https://www.ippc.int/static/media/files/publication/en/2016/01/ISPM_11_2013_En_2015-12-22_PostCPM10_InkAmReformatted.pdf

Zyra e Përfaqësuesit për Tregti të Shteteve të Bashkuara. (2016, Shtator). Udhërrëfyesi për Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave të SHBA . Gjetur në <https://ustr.gov/sites/default/files/GSP-Guidebook-September-16-2016.pdf#page=16>